

**URDHËR**  
**Nr. 257, datë 21.5.2021**

**MBI MARRJEN E MASAVE PËR ZBATIMIN E PLANIT TË MOBILIZIMIT, PËR  
NJË PERIUDHË TRANZITORE, DERI NË VËNIEN NË FUNKSION ME  
KAPACITET TË PLOTË TË SPITALIT RAJONAL “MEMORIAL” FIER**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 23/2021, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, mbi dhurimin në fushën e shëndetësisë”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 175, datë 17.3.2021, “Për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e Spitalit Rajonal ‘Memorial’ në Fier, si projekt pilot”, të ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 156, datë 10.2.2021, “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2021, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për Bashkinë Fier”, ligjit nr. 10 383, 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me qëllim miratimin dhe zbatimin e planit të mobilizimit deri në periudhën për vënien në funksionim normal të Spitalit Rajonal “Memorial” Fier,

**URDHËROJ:**

1. Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Spitalin Rajonal Vlorë, Spitalin Rajonal Fier, Spitalin Rajonal Gjirokastrë dhe Spitalin Bashkiak të Lushnjës të angazhohen maksimalisht për t’iu përgjigjur të gjitha nevojat për mallra dhe shërbime të domosdoshme për vënien në funksion të Spitalit Rajonal “Memorial” Fier, gjatë periudhës së mobilizimit prej 3 muaj, deri në përfundimin e procedurave ligjore organizative, administrative etj., për vënien në funksion me kapacitet të plotë të tij.
  2. Mallrat dhe shërbimet esenciale për mbulimin e nevojave gjatë periudhës së mobilizimit do të sigurohen respektivisht nga strukturat e cituara në pikën 1 të këtij urdhri, sipas kërkesave që do të përcillen nga Spitalit Rajonal “Memorial” Fier.
  3. Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Spitali Rajonal Fier, Vlorë, Gjirokastrë dhe Spitali Bashkiak Lushnjë do të mbulojnë nevojat e Spitalit Rajonal Memorial Fier për barna dhe materiale mjekësore.
  4. Shpenzimet shtesë të spitaleve të përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri për mbulimin e nevojave për mallra dhe shërbime esenciale të Spitalit Rajonal “Memorial” Fier, do të financohen nga FSDKSH-ja përmes rialokimeve të fondeve për llogari të këtyre institucioneve.
  5. Ngarkohet MSHMS-ja, FSDKSH-ja, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Spitali Rajonal “Memorial” Fier, si dhe spitalet rajonale të Vlorës, Fierit, Gjirokastrës dhe Spitali Bashkiak i Lushnjës, për zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES  
SOCIALE  
Gelardina Prodani**

## ANEKS NR. 1

### **Spitali Rajonal Vlorë**

Do të sigurojë mbulimin e nevojave të gatimit dhe të shpërndarjes së ushqimit në pavijonet e Spitalit Rajonal “Memorial” Fier, si dhe nevojat për materiale pastrimi dhe materiale kancelarie.

### **Spitali Rajonal Fier**

Do të sigurojë mbulimin e nevojave të:

- shërbimit të lavanderisë në pavijonet e Spitalit Rajonal “Memorial” Fier;
- shërbimit të trajtimit të mbetjeve të rrezikshme spitalore që do të prodhohen nga Spitali Rajonal “Memorial” Fier;
- për setet kirurgjikale të sterilizuara për Spitalin Rajonal “Memorial” Fier;
- për analiza laboratorike për Spitalin Rajonal “Memorial” Fier;
- materialeve të pastrimit.